



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë; E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al

Nr. 796/5 Prot.

Tiranë, më 30.11.2018

V E N D I M Nr. 176, Datë 30.11.2018

PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT PËR PROJEKTIN "FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE IV" "MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË" për periudhën nga fillimi i Projektit deri më datën 30.06.2018.

Nga auditimi i ushtruar në Fondin Shqiptar të Zhvillimit për Projektin "Fondi i Investimeve Sociale IV" rezultoi që, ka devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat nuk janë të përhapura dhe nuk janë materiale.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare" të ushtruar në Fondin Shqiptar të Zhvillimit për Projektin "Fondi i Investimeve Sociale IV", sipas programit të auditimit nr. 796/1 Prot., datë 13.07.2018, për veprimtarinë nga fillimi i projektit deri me datë 30.06.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i marrëveshjeve të financimit të projektit rezultoi se projekti “Fondi i Investimeve Sociale IV” bashkë financohet në bazë të tre marrëveshjeve të nënshkruara në datë 23.12.2010 dhe 19.12.2011 midis Qeverisë Shqiptare dhe KfW të ratifikuara me ligjet:

-Nr. 10.407 date 23.03.2011, marrëveshja e huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe KfW– së, për financimin e projektit “Fondi i Investimeve Sociale IV” shpallur me dekretin nr. 6971, datë 12.04.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë (20 milion euro).

-Nr. 10 408 datë 23.03.2011, marrëveshja e financimit dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (MF) dhe KfW-së për financimin e projektit financiar nga fondet e programit IPA 2009, në bazë të së cilit Bashkimi Evropian jep (8 milion e 820 mijë euro) si grand (me përjashtim të tarifës së menaxhimit të KfW-së).

-Marrëveshja e financimit dhe e programit (grandi i trajnimeve), datë 19.12.2011 për vlerën 400.000 mijë Euro, e cili është bërë efektive në datën 31.12.2013.

Ky projekt përbëhet nga dy komponentë nga të cilët i pari parashikon financimin e 8 segmenteve rrugore, ndërsa komponenti i dytë parashikon ndërtimin e 20-25 sistemesh ujësjellësish në qarqet veriore të vendit. Sipas marrëveshjes së financimit përcaktohet se KfW do t'i japë huamarrësit një hua që nuk i kalon 20 milion Euro duke i ndarë këto fonde përkatësisht 15 milion Euro për rikonstruksionin e rrugëve dhe 5 milion Euro për ndërtimin e ujësjellësve ruralë. Nga auditimi rezultoi se:

KfW në datë 19.12.2013 ka dhënë miratimin e saj për shtyrje të afatit të disbursimeve deri në datën 30.06.2017 dhe afati i disbursimeve është shtyrë deri në këtë datë në bazë të Ligjit 139/2014 miratuar në datë 16.10.2014, për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, e FSHZH dhe KfW për financimin e programit “Fondi i Investimeve sociale IV”. Aktualisht në bazë të korrespondencave të shumta ndërmjet FSHZH, MF dhe KfW rezulton se kjo e fundit me shkresën dërguar në datë 06.07.2017 (një javë mbas skadimit të afatit për disbursimin e fundit) protokolluar në MF me nr. prot 10640 datë 25.07.2017 sqaron se është e gatshme të shtyjë afatin e disbursimeve deri në 31.03.2018. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 7-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1-Rekomandimi:- FSHZH/Drejtorja e menaxhimit të projekteve, në të ardhmen të marrë masat e duhura që ecuria e disbursimeve për projektet e financuara nga KfW apo donatorë të tjerë të huaj, të përfundojë brenda afateve të përcaktuara në marrëveshjet e financimit, në mënyrë që të eliminohen kostot shtesë që mbart zgjatja në kohë e afatit të disbursimit si dhe me qëllim shmangien e procedurave të tej zgjatura që nevojiten për miratimin e ndryshimeve financiare në marrëveshjet e ratifikuara.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 1544 datë 21.11.2016 të FSHZH drejtuar Ministrin të Financave është kërkuar rialokim fondesh të lira, në kuadër të programit “Fondi i investimeve sociale IV” për në kategorinë e “Rehabilitimit dhe ndërtimit të afro 100 km rrugë” me qëllim financimin e mëtejshëm të kontratave që janë në zbatim e sipër si dhe financimin e punimeve

civile si dhe mbikëqyrjen e një kontrate të re. Në shkresën e sipërcituar sqarohet se në kategorinë e “Fondit Rezervë” të secilës prej marrëveshjeve financiare të cilat bashkë financojnë komponentin e rindërtimit të rrugëve të programit “Fondi i investimeve Sociale IV” ka fonde të lira, gjithashtu janë përfituar fonde të lira nga dy kategori financimi që i përkasin dy marrëveshjeve, konkretisht, në kategorinë “Përgatitje e projektit teknik dhe procedurave mjedisore” tek pjesa e cila financohet nga marrëveshja e grandit IPA 2009 janë përfituar fonde të lira në vlerën 0.15 milion euro, ndërsa në kategorinë “Prokurim dhe menaxhim i kontratave” tek pjesa që financohet nga marrëveshja e huas dhe programit me KfW- në janë përfituar fonde të lira në vlerën 0.2 milion euro. Vlera totale e rialokimit të fondeve të lira e cila propozohet nga AZP/FSHZH, është në vlerën totale prej 2.6 milion euro, e cila vjen si shumë e 0.15 milion euro të përftuara nga kategoria “Përgatitja e projektit teknik dhe procedurave mjedisore”, të cilat janë parashikuar në marrëveshjen e financimit dhe programit të grandit IPA 2009. Vlera prej 0.2 milion euro të përdorura nga kategoria “Prokurimi dhe menaxhimi i kontratave, të cilat janë parashikuar në marrëveshjen huas dhe programit të lidhur me KfW-në. Palët referuar korrespondencave zyrtare dhe shkresave të shumta të vënë në dispozicion nga FSHZH kanë rënë dakord ndërmjet tyre për ndryshimin e komponentëve, por një ndryshim i tillë nuk është bërë konform përcaktimeve të Ligjit nr. 43/2016 datë 21.04.2016 “Për Marrëveshjet Ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 21-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1-Rekomandimi:- FSHZH/Drejtoria Juridike të marrë masa që në të ardhmen për të gjitha projektet me financime të huaja në rastet e rialokimeve të fondeve për komponentët e projekteve të ndjekë të gjitha procedurat e duhura ligjore, për ndryshimet përkatëse në marrëveshjet e financimit sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 43/2016, datë 21.04.2016, duke ndjekur hap pas hapi të gjithë ecurinë e tyre deri në fazën e miratimit nga Kuvendi.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: - Nga auditimi ka rezultuar se referuar objektivave të marrëveshje janë realizuar:

-16 ujësjellës dhe linja transmetimi në një kohë që marrëveshja parashikon të kryhen 20 ujësjellës jo në përputhje me objektivat e programit të përcaktuara në aneksin nr. 1 të marrëveshjes.

-Është financuar në shumën 30,506.6 mijë lekë (furnizim i sahateve në qytetin e B. Currit) jashtë përcaktimeve në Plan projektin e programit në kundërshtim me pikën I.1 të marrëveshjes së financimit, ku programi trajton rehabilitimin, rindërtimin ose ndërtimin e sistemeve të ujësjellësve ruralë dhe nëse është e zbatueshme, shërbimet bazë të kanalizimeve të ujërave të zeza (Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 21-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 -Rekomandimi- Nga Njësitë e projekteve të FSHZH në të ardhmen të kryhen studime dhe analizime paraprake (me skenarë rezerve) referuar fondeve të miratuara nga kreditë dhe grandet, në mënyrë që të maksimizojnë efektivitetin e përdorimit të fondeve në zbatim të objektivave të projekteve për të cilat këto fonde janë vënë në dispozicion.

Vazhdimisht

4. Gjetje nga auditimi: - Nga auditimi ka rezultuar se janë ndryshuar zërat e komponentëve ujë dhe rrugë ku megjithëse është marrë miratimi nga kreditori dhe huamarrësi jo në të gjitha

rastet është bërë me aktet ligjore e nënligjore sipas parashikimeve në kuadrin ligjor në fuqi, veprim që bie në kundërshtim me *ligjin 43/2016 "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë"* nenin 23. Kështu në komponentin e ujit është pakësuar fondi rezerve i cili është zeruar në favor të zërit "Përgatitje e projektit teknik supervizion + asistencë teknike".

Ndryshimet e para në komponentin ujë kanë marrë miratimin me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 13.02.2013 me propozimin e Ministrit të Financave. Ndryshimi i dytë është bërë me miratimin e palëve (FSHZH, Ministri e Financave dhe KfV referuar inicimit me shkresën e Agjencisë së zbatimit të projektit "Fondi i Investimeve Sociale IV" (FSHZH) drejtuar Ministrit të Financave me shkresën nr. 983/1, datë 04.05.2015 dhe ky i fundit KfW me shkresën nr. 6670/1, datë 11.05.2015 dhe ku është marrë dakordësia me 2 Korrik të vitit 2015. Për sa më sipër është informuar z/Kryeministri me shkresën e Ministrit të Financave nr. 6670/3, datë 1.09.2015, por nuk u vu në dispozicion miratimi me vendim të KM.

Për komponentin Rrugë për ndryshimet e konstatuara midis zërave komunikime të cilat kanë marrë miratimin nga KfW me 25.07.2017 dhe nga Ministri i Financave me shkresën nr. 10760/1 datë 4.08.2017 pavarësisht indicies për ndryshim nga FSHZH me shkresën drejtuar Ministrisë së Financave me nr. 1544, datë 21.11.2016.

Gjithashtu nga auditimi i pagesave të kryera ka rezultuar se për ujësjellësit pjesë e projektit "Fondi i Investimeve Sociale IV" me miratimin e KfW janë alokuar dhe fonde të mbetura nga projektet "Programi Rural i Furnizimit me ujë, Faza I, të datës 13.12,2007 dhe "Programi Rural i Furnizimit me ujë, Faza II" të datës 23.12.2008, kjo referuar faktit të përputhjes së objektivave dhe mënyrës së përzgjedhjes së ujësjellësve për komponentin e ujit në projektin "Fondi i Investimeve Sociale IV". Nga këto projekte janë miratuar fondet referuar letërkëmbimeve në shumën 527,699.57 Euro nga RWSP Faza e I dhe RWSP Faza II ose në shumën 73,146.005.81 lekë dhe përdoruar në likuidimin e situacioeve për kontratën e lidhur me JV A.I & H. me kod WS/ICB/2013/CW1. Edhe për përdorimin e këtyre fondeve nuk janë nxjerrë me akte ligjore apo nën ligjore (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 21-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1-Rekomandimi- Nga zyra juridike e FSHZH në bashkëpunim me njësitë e projekteve të FSHZH, në të gjitha rastet e ndryshimeve të marrëveshjeve, ku përmendim kostot, objektivat, afatet apo financimet e nënkategorive të komponentëve (pavarësisht mos ndryshueshmërisë së totalit të financimit) të ndiqen procedurat e miratimit në çdo rast konform përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë".

Vazhdimisht

4.2-Rekomandimi- Ndryshimet përkatëse të ndiqen dhe miratohen hap pas hapi në kohën e evidentimit të argumentuar të tyre, me qëllim shmangien e vonesave të pa argumentuara dhe jo efektive në zbatimin e projekteve përkatëse.

Vazhdimisht

5. Gjetje nga auditimi: - Nga auditimi ka rezultuar se FSHZH nuk ka respektuar skedula e disbursimeve e përcaktuar në ligjin nr. 10407, datë 31.03.2011, të ndryshuar me ligjin nr. 139/2014 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe KfW Frankfurt Am Main për financimin e programit "Fondi i investimeve sociale IV", (kjo si rezultat i ecures së nënprojekteve të investimeve në rrugë dhe ujësjellës jo sipas parashikimeve të grafikut kohor të punimeve). Kjo ka bërë që tarifa e përkushtimit e

paguar nga Ministria e Financave si huamarrësi, të jetë e ndryshme nga ajo e planifikuar konform tabelës së disbursimeve të miratuar me ligjet sa më sipër. Për këtë nga Ministria e Financave është paguar 52,534.05 euro (137,444.05 – 84,910) më shumë për këtë tarifë nga ajo e planifikuar sipas planit të disbursimeve të miratuar në ligjin nr. 139/2014 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3 faqe 21-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

5.1-Rekomandimi- Nga Njësitë të projekteve në FSHZH në të ardhmen, pavarësisht detyrimit të Ministrisë së Financave si Huamarrësi, për pagesat e kredisë të përcaktuara në marrëveshje *(edhe të pagesave të përkushtimit, kryesisht me kreditor KFW)*, të ndiqen me përparësi krahas zbatimit të punimeve në cilësi dhe brënda afateve kohore të lëvrimit të fondeve, por dhe sasia e fondeve të lëvruara kundrejt punimeve të kryera dhe planit të miratuar të disbursimeve, duke shmangur në këtë mënyrë kostot shtesë të Kredisë.

Vazhdimisht

6. Gjetje nga auditimi: - Nga auditimi ka rezultuar se fondet e SIF IV dhe të IPA 2009, referuar marrëveshjes së ratifikuar me ligjin nr. 10407, datë 31.03.2011, të ndryshuar, janë audituar nga auditues i kontraktuar nga Ministria e Financave. Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, raporti dhe opinioni i auditimit për vitin 2016 ka përfunduar nga kompania audituese “G.Th” më 19, Dhjetor të vitit 2017 për rrugët dytësore dhe rurale dhe për ujësjellësit ruralë më 13 Dhjetor të vitit 2017. Dërgimi i këtyre raporteve KFW është bërë me shkresat e konfirmuara nga Drejtori Ekzekutiv i FSHZH me datën 5 janar të vitit 2018, në një kohë që në marrëveshje tek rubrika Termat e referencës: Auditimi i "fondit (eve) të disponimit" theksohet se *“Auditimi do të kryhet çdo vit (Periudha e auditimit) dhe raporti (etj) përkatës/e duhet të paraqiten jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar...”, pra auditimi i këtyre fondeve ka përfunduar pas periudhës 6 mujore dhe për rrjedhojë edhe njoftimi është kryer me vonesë në kundërshtim me përcaktimet në marrëveshje.*

Theksojmë se auditimi i fondeve kontraktohet nga huamarrësi që është Ministria e Financave dhe se për vitin 2017 nuk janë audituar fondet dhe nuk ka një raport auditimi, megjithëse ka përfunduar periudha 6 mujore e përfundimit të auditimit të fondeve për vitin 2017 (moment i auditimit nga KLSH) *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 32-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

6.1-Rekomandimi: - Nga Drejtoria e Financës të merren masa që me shkresën përcjellëse të dorëzimit të pasqyrës financiare për vitin përkatës në Ministri të Financës dhe Ekonomisë, të theksohet dhe të iniciohet disponueshmëria e Njësitë të Projektit dhe zyrës së financës për auditimin e fondeve, referuar afateve të përcaktuara në marrëveshjet përkatëse, brenda muajit Qershor, si dhe vënia në dispozicion e konkluzioneve të auditimit kreditorit brenda këtyre afateve.

Vazhdimisht

7. Gjetje nga auditimi:- Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2016 dhe 2017 të FSHZH u konstatua se në aktiv të bilancit në rubrikën “Aktive të qëndrueshme të pa trupëzuara” në vlerat 4,079,948,906 lekë për vitin 2015, 4,797,199,468 lekë për vitin 2016 dhe 5,641,777,120 lekë për vitin 2017, referuar sqarimeve dhe shpjegimeve të plotësimit të pasqyrave financiare, janë përfshirë përveç kostos së investimit për shpenzimet e projektimit si dhe diferenca e të ardhurave dhe shpenzimeve në vite që në bazë të udhëzimit nr. 14, datë 21.12.2006 kanë kaluar në llogarinë 230, paraqiten dhe kostot e supervizionit të nënprojekteve, kostot e shërbimeve të konsulentëve teknike të projekteve, veprim që bie në kundërshtim me klasifikimet dhe

përmbajtjen e rubrikave të çdo posti të pasqyrave financiare të shpjeguara në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësisive që varen prej tyre si dhe të njësisive të menaxhimit / zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”, të ndryshuar. Referuar manualeve teknike si dhe udhëzimeve “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, këto kosto i bashkohen vlerës së investimeve për ndërtim e rikonstruksione dhe duhet të pasqyroheshin në zërin shpenzime në proces për transferime kapitale (ku duhej të bashkoheshin me vlerën e investimeve të kryera për dy komponentët ujë dhe rrugë dhe duke ju ngarkuar proporcionalisht vlerës së secilit investim para transferimit.

Nga zyra e financës së FSHZH është deklaruar se projekti nuk është mbyllur dhe këto shuma nuk i kanë kaluar përfituesve (NJQV) sipas investimit në rrugë dhe ujësjellës, pavarësisht marrjes në inventar fizikisht nga ana e NJQV.

b. Referuar praktikës së deklaruar nga zyra e financës së FSHZH për kalimet kapitale për projekte të tjera, ku ky kalim bëhej referuar procesverbaleve të marrjes në dorëzim të investimeve, dokumentacionit teknik dhe shkresës së titullarit të institucionit, rezultoi se nga FSHZH, para shkarkimit të shumave nga kontabiliteti, nuk merrej dokumentacion kontabël nga NJQV i regjistrimit të aktivitetit me vlerën e plotë të tij (duke përfshirë dhe vlerën e supervizionit dhe konsulentit), veprim në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve të njësisë në sektorin publik”, të ndryshuar.

c. Gjithashtu në rubrikën “Aktive të qëndrueshme të pa trupëzuara” nuk është plotësuar zëri “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të pa trupëzuara për pjesën e projekteve (vlerës së tyre) sipas inventarit në secilin vit respektiv. Ky veprim bie në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar neni 22 pika 4 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 32-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1- Rekomandimi - Nga zyra e financës të kryhen korrektimet përkatëse për kalimin e shumave të kostove të supervizionit të nënprojekteve dhe kostove të shërbimeve të konsulentëve teknike nga zëri “aktive të qëndrueshme të patrupëzuara, në zërin “shpenzime në proces për transferime kapitale” duke ju bashkuar proporcionalisht vlerës së investimit të çdo nënprojekti (investimi në rrugë apo ujësjellësi në rastin konkret) konform akteve në fuqi.

7.2- Rekomandimi - Nga zyra e financës në procesin e transferimit kapital të investimit, krahas dokumentacionit teknik dhe urdhrat të Titullarit të Institucionit, përpara çregjistrimit kontabël nga kontabiliteti i FSHZH, të marrë domosdoshmërisht regjistrimin kontabël nga njësi publike ku është bërë transferimi, konform akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

7.3- Rekomandimi - Nga zyra e financës të bëhen llogaritjet përkatëse të amortizimit të projekteve për çdo vit, referuar kohës së inventarizimit të çdo projekti, konform përqindjes së përcaktuar në aktet ligjore në fuqi.

Vazhdimisht

8. Gjetje nga auditimi: -a. Nga auditimi me zgjedhje i pagesave të situacioneve për punimet në komponentin rrugë dhe ujë rezultoi se :

Për rrugën Tamarë -Vermosh loti 2 me kod WL-REC 46-2 (kontraktori CS E.):

-*Ka rezultuar 1 rast i kalimit të TVSH nëpërmjet thesarit dhe fatura bashkëlidhur nuk ka konfirmimin e thesarit.*

- *Ka rezultuar 1 rast në shumën 20,844,309 lekë kur shuma e paguar është më e vogël se 30,000,000 lekë, veprim që bie në kundërshtim me pikën 14.6 të kushteve të kontratës.*

- *Ka rezultuar 1 rast në shumën 597,160 lekë të pagesës së TVSH* jo nga thesari por nga llogaritë jashtë thesarit (banka të nivelit të dytë) të cilat kanë të ardhura të destinuar për pagesa sipas destinacioneve të përcaktuara në marrëveshjet e kredive për FSHZH si Agjenci e zbatimit të projekteve

- *Ka rezultuar 1 rast në shumën me tvsh 3,582,960 lekë të pagesës së punimeve të kryera dhe të paraqitura* me situacion punimesh pas datës së marrjes në dorëzim, në një kohë që punimet janë të programuara që në preventivin dhe për të cilat nuk janë mbajtur sanksionet sipas përcaktimeve në kontratë.

Për *Rrugën Nacionale – Iballë Loti 1* me kod WL - Rec83 kontraktor “Firma JV A. & N. E.

- *Kanë rezultuar 2 raste në shumën 25,628,250 lekë kur shuma e paguar është më e vogël se 30,000,000 lekë*, veprim që bie në kundërshtim me pikën 14.6 të kushteve të kontratës ku cirtohet se “çdo pagesë duhet të jetë jo më e vogël se 30,000,000 lekë

-*Kanë rezultuar 5 raste në shumën 48,645,982 lekë të pagesës me vonesë të faturës*, që bëhen me fondet e KfW (IPA 2009 dhe KfW) por dhe të tvsh që paguhet me fondet e buxhetit të shtetit, pra më vonë se 28 ditë (parashikim në kontratë) ose më vonë se një muaj në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.2, datë 6.02.2012 “Për procedurat Standarde të zbatimit të Buxhetit” të ndryshuar si:

-*Ka rezultuar 1 rast në shumën 7,793,765 lekë të pagesës së TVSH* jo nga thesari.

Për rrugën Rruga Nacionale – Qelëz kod WL - Rec82 kontraktor “JV D. G. & E..

Kanë rezultuar 2 raste në shumën 18,094,708 të pagesës së TVSH jo nga thesari.

Kanë rezultuar 9 raste në shumën 66,049,650 lekë të pagesës së TVSH nga thesari të likuiduar me vonesë.

Ka rezultuar 1 rast i pagesës për punime të kryera pas marrjes në dorëzim të punimeve (përfundimit të kontratës) dhe periudhës së garancisë si dhe i pagesës me vonesë në shumën 5,455,469lekë

Për pagesat për ujësjellësit sipas kontratës me nr. WC/ICB/2013CWI me kontraktor JV “N.H. shpk & A.”

Kanë rezultuar 3 raste në shumën 43,706,959 lekë të pagesës së TVSH dhe Kontributit Lokal (GOA) jo nga thesari, por nga bankat e nivelit të dytë.

Fenomeni i pagesës së TVSH me vonesë është prezent dhe në pagesat e ndërtimit të ujësjellësve, ku shpesh herë vonesat vinin dhe si rezultat i paraqitjes me vonesë të dokumentacionit nga departamenti i infrastrukturës.

b. Gjithashtu u konstatua se pagesat me vonesë të TVSH dhe Kostos Lokale si dhe pagesat shpesh herë të tyre jo nga thesari (ku buxheti i shtetit duhet të ishte financuesi i këtyre fondeve) por nga llogaritë në bankat e nivelit të dytë, ku destinacioni i fondeve në këto llogari ka qenë për pagesa sipas përcaktimeve në marrëveshjet përkatëse, ka rezultuar si pasojë e mungesës së fondeve për TVSH dhe Kosto Lokale të çelura nga buxheti i shtetit në vitet përkatëse dhe kjo për faktin se dhe planifikimi i nevojave për këto fonde është bërë në bllok dhe jo sipas secilit program të FSHZH dhe jo në nivel nënprojekti (investimi) konform kërkesave të përcaktuara, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 8 të Ministrisë së Financave, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afat mesëm” neni 128,138 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 32-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1 Rekomandimi:- Nëpunësi Autorizues i FSHZH për efekt të menaxhimit të afatit kohor prej 28 ditësh (afat i përcaktuar në kontratat e lidhura) nga data e paraqitjes së faturës dhe

situacionit të kontraktorit për pagesë përkatëse, të përcaktohen afatet për drejtorinë e infrastrukturës dhe zyrën e financës si dhe hallkat e tjera ku duhet të kalojë praktika për përpunim dhe miratim, afate të cilat duhet të kenë limitin prej 28 ditësh, në mënyrë që të shmangjen vonesat dhe përcaktohen përgjegjësitë.

8.2 Rekomandimi:- Nga Nëpunësi Autorizues i FSHZH si dhe Drejtuesit e Programeve të FSHZH, referuar projekteve dhe nënprojekteve të përfituara nga marrëveshjet e kredisë dhe grandet, në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit të Ministrisë së Financave, për efekt të shmangies së pagesave nga llogari të tjera, që duhet të bëhen vetëm nga Thesari dhe kontrollit të pagesave (financim buxhetor), të realizohet planifikimi i fondeve për TVSH dhe Kosto Lokale në nivel programi dhe nënprojekti për çdo vit, referuar grafikut të punimeve të secilit investim(nën projekti), konform kërkesave të akteve ligjore e nënligjore në fuqi të përgatitjes së programit buxhetor vjetor dhe afat mesëm.

8.3 Rekomandimi:- Nga Nëpunësi Zbatues i Institucionit dhe Nëpunësi Autorizues të respektohen kryerja e pagesave nga llogaritë përkatëse (në bankat e nivelit të dytë) për shpenzime të cilat janë të destinuara fondet e këtyre llogarive, konform përcaktimeve në marrëveshje.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: - Nga auditimi ka rezultuar se ka raste të pagesave të garancisë (5 % i dytë) që bëhet nga KfW në Bankat e nivelit të dytë, kundrejt garancisë së kontraktorit. Kjo lloj pagese (retention moneu garante) parashikohet në kushtet e përgjithshme të kontratës. *Gjithashtu ka rezultuar se jo në të gjitha rastet kjo garancie është çliruar mbas marrjes përfundimtare në dorëzim dhe me kërkesën me shkrim të titullarit të FSHZH, pasi referuar rastit të kontratës (rruga nacionale- Qelëz) garancia e garancisë është deri më 15 tetor 2015 bërë në BKT më 15 qershor të 2015 (ku citohet se lirohet me mbushjen e këtij afati). Aktualisht për këtë aks- rrugor nuk ka marrje në dorëzim (pasi certifikata e marrjes në dorëzim e ndodhur në praktikën e financës në momentin e pagesës nuk është firmosur as NJQV as inxhinieri supervisor). Nuk ka gjithashtu marrje përfundimtare në dorëzim, në një kohë që në zyrën e financës (në dosjen e pagesave të kontraktorit për kontratën Rruga Nacionale- Qelëz) nuk ka asnjë dokumentacion që të argumentojë që kontraktori është i çliruar nga të gjitha detyrimet e përcaktuara në kontratë (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 32-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1-Rekomandimi- Nga FSHZH të miratohet një dokument standard për garancinë e bërë për “Retention money garante”, ku domosdoshmërisht të përcaktohet klauzola e lirit të garancisë pas marrjes përfundimtare në dorëzim të punimeve të kontraktuara dhe se kjo garanci të lirohet me kërkesën me shkrim të autoritetit kontraktor (FSHZH) dhe ku ky dokument të jetë pjesë e dosjes së pagesave në zyrën e financës.

Brenda datës 31.12.2018

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se si për kontratat e rrugëve, ashtu dhe për kontratën e ujësjellësve, bashkëlidhur faturës, është vendosur situacioni i punimeve. Format i situacionit bashkëlidhur është i formatuar në mënyrë të tillë ku garancia e punimeve mbahet 10 % (sipas përcaktimeve në kontratë) mbi shumën e punimeve dhe jo mbi shumën totale të faturës me TVSH, apo punimeve me TVSH, duke mos u përputhur fatura e paraqitur me shifrat e situacionit bashkëlidhur. Pra shuma e likuiduar e punimeve në situacion nuk përputhet me shumën për tu likuiduar në faturë në kundërshtim me nenin 101 të ligjit nr.92/2014”Për tatimin

mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar dhe udhëzimin në zbatim të tij. Kjo ka bërë që subjekti me përfundimin e punimeve ka marrë 100 % të TVSH së punimeve dhe 90 % situacionin e punimeve dhe jo në mënyrë proporcionale, duke krijuar rrisje për rastet kur kontraktori dështon në realizimin e defekteve gjatë periudhës së garancisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 32-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1 -Rekomandimi-Nga FSHZH për efekt të përputhjes së situacionit me faturën tatimore të prerë për këtë situacion, për shërbimet (punimet) e kryera, për efekt të mbajtjes së garancisë së punimeve, shuma e zbritur e 10 % të aplikohet mbi faturën tatimore të prerë nga kontraktori dhe jo mbi situacionin e punimeve pa TVSH, konform kërkesave të akteve ligjore në fuqi.

Menjëherë dhe vazhdimisht

11. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion mbi administrimin e veprave të dorëzuara rezulton se nuk është marrë në dorëzim nënprojekti “*Rikonstruksioni i rrugës Nacionale - Qelëz*”, nga ish komuna Qelëz, cili më datë 25.09.2014 ka përfunduar punimet për rehabilitimin e 12.8 km rrugë. Bazuar në Marrëveshjen e Investimit të lidhur më datë 20.08.2013 me NjQV ish -Komuna Qelëz, është lëshuar Certifikata e Përfundimtare e Punimeve më datë 15.10.2014 nga supervizori i punimeve e cila nuk është firmosur nga të gjitha palët. Certifikata e marrjes në dorëzim të nënprojektit e cila nuk përmban datë është firmosur vetëm nga supervizori, kontraktori dhe FSHZH. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore nuk ka pranuar ta firmosë certifikatën e marrjes në dorëzim të nënprojektit duke mos ju përmbajtur marrëveshjes së investimit së nënshkruar mes palëve në kundërshtim me nenin 2 dhe 4 të saj. Me shkresën nr. 2086 datë 02.12.2014 të FSHZH drejtuar komunës Qelëz është kërkuar marrja e përkohshme në dorëzim e objektit. Nga korrespondenca ndërmjet palëve rezulton se me shkresën nr. 2382 datë 29.12.2014 të FSHZH i është rikërkuar komunës firmosja e certifikatës përfundimtare të punimeve. Me shkresën nr. 05 datë 07.01.2015 të kryetarit të ish-komunës Qelëz sqarohet se komuna Qelëz nuk ka burimet njerëzore për certifikimin e punimeve. Gjithashtu, do ti drejtohet Këshillit të Qarkut Shkodër për ngritjen e një grupi pune pasi ky segment rrugor është në varësi të këshillit të qarkut Shkodër. Kësaj shkrese FSHZH i është përgjigjur me shkresën nr. 297 prot datë 30.01.2015 ku sqaron se kompetente për marrjen në dorëzim të segmentit rrugor është ish komuna Qelëz. Nga FSHZH nuk rezulton të jetë marrë asnjë masë tjetër kundrejt ish komunës me qëllim marrjen e përkohshme në dorëzim të rrugës së investuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 60-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1-Rekomandimi:- FSHZH të analizojnë situatën e krijuar dhe të ndërmarrin të gjitha masat e duhura administrative dhe ligjore për zgjidhjen e situatës së krijuar ndërmjet FSHZH dhe ish Komunës Qelëz, me qëllim marrjen sa më të shpejtë në dorëzim të segmentit rrugor Rrugë Nacionale – Qelëz, me synim realizimin e mirëmbajtjes rutinë dhe periodike, duke shmangur kosto të larta në të ardhmen për rikonstruksionin e saj.

Brenda datës 31.12.2018

12. Gjetje nga auditimi:

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 252/8, datë 30.06.2016, rezultoi se zbatimi i rekomandimeve është verifikuar edhe në bazë të programit të auditimit nr. 1119, datë 05.11.2016 të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe me shkresën nr. 1119/113 datë 20.01.2017 është rikërkuar zbatimi i rekomandimeve të

pa zbatuara të KLSH, ku nga auditimi kanë rezultuar të pa zbatuara 2 masa organizative, të zbatuara pjesërisht 1 masë shpërblim dëmi, në proces zbatimi 12 rekomandime dhe të zbatuara plotësisht 14 rekomandime. Gjithashtu, rezultoi se Fondi Shqiptar për Zhvillim (FSHZH) nuk ka zbatuar afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve të lëna me shkresën 252/8 datë 30.06.2016, në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe nuk ka paraqitur pranë KLSH asnjë dokument mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, në kërkesë të zbatimit të pikës 2, të nenit 30, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, mbi zbatimin e afatit 6 mujor për raportimin e ecurisë së përmbushjes së rekomandimeve të lëna me shkresën 252/8 datë 30.06.2016. Nuk rezulton te jetë hartuar asnjë plan masash në lidhje me rekomandimet e lëna nga kontrolli i lartë i shtetit me shkresën e sipërcituar si dhe nuk janë përcaktuar departamentet apo personat përgjegjës për realizimin e tyre (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 7-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1-Rekomandimi: - FSHZH të marrë masa që në të ardhmen për të gjitha rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit të hartojë plane masash konkrete duke përcaktuar personat dhe drejtoritë përgjegjëse për realizimin e tyre si dhe të informojë brenda afateve të përcaktuara ligjore mbi ecurinë e zbatimit të tyre KLSH.

Në vazhdimësi

12.2-Rekomandimi: - FSHZH të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve të përcaktuara nga auditimet e mëparshme të kryera nga KLSH, të dërguara në FSHZH me shkresën nr. 1119/113 datë 20.01.2017.

Brenda datës 31.12.2018

B.1 MASA SHPËRBLIM DËMI

Kanë rezultuar shkelje me dëm ekonomik në vlerë 5,398,916 lekë, i cili në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: -Kontrata “Rikonstruksion i rrugës Rrugë Nacionale-Qelëz” është nënshkruar me vlerë 470,949,438 lekë. Nga auditimi i dokumentacionit dhe verifikimi i disa zërave të punimeve të realizuara në objekt, kanë rezultuar diferenca të punimeve të realizuara krahasuar me ato të certifikuar me vlerë **3,920,758 lekë, si më poshtë:**

- Sipas ndryshimit nr. 1, datë 31.12.2013, ndër të tjera është parashikuar ndërtimi i një ure të re në km 8.250. Nga verifikimi i situacionit përfundimtar rezulton se është ndryshuar çmimi i gërmimit të dherave i cili nga 300 lekë/m³ është bërë 600 lekë/m³. Po ashtu, në situacionin përfundimtar sasia e mbushjes për shpatullat e urës është rritur në 3202.8 m³, nga 1838 m³ të parashikuar, ndërkohë që nuk ka ndryshim të projektit. Punimet e mbushjes për urën janë përfshirë nga progresivi 8+200 deri në 8+350, pra në distancë 150 ml. Sa më sipër janë certifikuar punime të pa realizuara dhe rritje çmimi si më poshtë:

Mbushje: $3202.8 \text{ m}^3 - 1838.4 \text{ m}^3 \times 300 \text{ lekë/m}^3 + \text{TVSH} = 491,184 \text{ lekë}$.

- Pas auditimit të sigurisë rrugore është parashikuar dhe certifikuar furnizimi dhe vendosja e guardrail në sasinë tip N 2, në sasinë 148 ml. Nga verifikimi në objekt nuk rezulton të jetë vendosur guardrail më këto specifikime. Nga ana e Kontraktorit është përfituar padrejtësisht vlera **752,314 lekë** [(148 ml x 4,236 lekë/ml) + TVSH], vlerë e cila përbën dëm ekonomik.

- Nga verifikimi sipas zërit të punimeve nr. 8.7 “F.V guardrail me zgjatim për këmbësorë”, rezultoi se është realizuar sasia 437 ml, ndërkohë që është certifikuar dhe likuiduar sasia 882 ml, me një diferencë 437 ml. Në sasinë e certifikuar, është përfshirë edhe sasia 50 ml, e cila është shtuar sipas urdhër ndryshimit nr. 2, pas realizimit të auditimit të sigurisë rrugore.

Sa më sipër, nga ana e Kontraktorit është përfituar padrejtësisht vlera **1,835,400** lekë [(437 ml x 3,500 lekë/ml) + TVSH], vlerë e cila përbën dëm ekonomik.

- Nga verifikimi i realizimit të zërit të punimeve nr. 7.18 “F.V tub çeliku Ø 400 mm”, rezulton se është certifikuar sasia 69.5 ml dhe realizuar në fakt sasia 47.5 ml. Nuk është realizuar vendosja e tubit në kilometër 1+490 në sasinë 12 ml, në kilometër 9+800 në sasinë 10 ml. Në kilometër 1+490, rezulton tubacion ekzistues, për ujitjen me diametër 300 mm, ndërsa në kilometër 9+800, është vendosur tub me material plastik. Vlera **198,000** lekë [(22 ml x 7,500 lekë/ml) + TVSH], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

- Nga verifikimi i zërit të punimeve nr. 7.19 “Mure guri llaç çimento për mbrojtje nga erozioni” rezultoi se sasia e certifikuar është 1624 m³. Nga kjo sasi, është certifikuar sasia 154.6 m³, e cila përfaqëson mure të vegjël, në gjatësi të kanalit anësor në kilometër 0+205, 0+430, 1+677, 1+773 dhe 7+000. Nga verifikimi rezulton se është realizuar sasia 87 m³, me diferencë 87.6 m². Për arritjen e rezultatit u bë matja e sipërfaqes së realizimit të tyre me sondazhe nga ku rezultoi se janë ndërtuar 46 mure me sipërfaqe afërsisht 2 m² dhe 83 mure me sipërfaqe afërsisht 1 m², ndërsa lartësia e tyre afërsisht 0.5 m. Muret nuk janë ndërtuar sipas profileve të paraqitura në vizatimet përfundimtare, por në përshtatje me terrenin, kjo e vërtetuar në vend për disa mure të cilëve u ishte zbuluar themeli, nga lëvizja e ujërave. Nga ana e kontraktorit është përfituar padrejtësisht vlera **643,860** lekë [(87.6 m³ x 6,125) + TVSH], vlerë e cila përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika 12.1 dhe 12.2.a (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 49-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 -Rekomandimi:- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **3,920,758** lekë, nga Kontraktori “**JV “D.G” dhe “E.”**”, vlerë e përfituar padrejtësisht si pasojë e certifikimit të punimeve të pa realizuara në fakt.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Kontrata e punimeve civile “Ndërtimi i 15 skemave të ujësjellësve në zonat Shkodër, Kukës dhe Dibër”, është nënshkruar me datë 30.06.2014, me Kontraktorin JV “N. H. Sh.p.k & A.i” me vlerë 587,179,225.8 lekë.

Kontratës i është bërë ndryshimi nr. 3, datë 21.08.2015, i cili ka të bëjë me ndërtimin e linjës kryesorë të Fshatit Sopanikë, Dibër.

Nga verifikimi i dokumentacionit të përlllogaritjes së vlerës së punimeve shtesë rezultoi se ka mangësi në hartimin e analizave të çmimeve për disa zëra të rinj të punimeve, të cilat kanë rezultuar të nevojshme për zbatim. Kontraktorit i është kërkuar paraqitja e këtyre çmimeve, duke analizuar koston e tyre, të cilën e ka paraqitur me mangësi për zërat e punimeve nga ku ka rezultuar se nga ana e Kontraktorit është përfituar padrejtësisht vlera **1,211,904** lekë, e cila **përbën dëm ekonomik si më poshtë:**

- Beton shtrese C 20/25 për soleta, për sasinë 19.1 m³, me çmim preventivi 14,000 lekë, çmim të aplikuar 25,200 lekë, nga ku është përfituar padrejtësisht vlera 256,704 lekë.

- Beton shtrese C 8/10 për shtresë, për sasinë 3.12 m³, me çmim preventivi 11,000 lekë, çmim të aplikuar 22,386 lekë, nga ku është përfituar padrejtësisht vlera 41,184 lekë.

- Punime ekskavatori për zhvendosje gurë në shtratin e lumit, për sasinë 50 orë pune, me çmim manuali 4,800 lekë, çmim të aplikuar 7,000 lekë, nga ku është përfituar padrejtësisht vlera 132,000 lekë.

- Punime saldimi për shkëputje lidhje të pa ligjshme, për sasinë 160 orë pune, me çmim manuali 2,667 lekë, çmim të aplikuar 5,400 lekë, nga ku është përfituar padrejtësisht vlera 524,736 lekë pa TVSH.

Po ashtu, nga ana e kontraktorit është përfituar padrejtësisht vlera 257,280 lekë, për punime hidroizolimi pa respektuar specifikimet teknike. Është vepruar në kundërshtim me Kushtet e Përgjithshme të Kontratës Pika 12.3 "Vlerësimi" (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 49-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.2 -Rekomandimi:- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **1,211,904 lekë**, nga Kontraktori "JV "N. H. Sh.p.k & A.i", vlerë e përfituar padrejtësisht si pasojë e aplikimit të çmimeve për zëra të rinj punimesh, në kundërshtim me manualët e çmimeve të punimeve të ndërtimit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: - Nga auditimi ka rezultuar se nga zyra e financës së FSHZH nuk është mbajtur sanksion sipas kushteve të kontratës për rrugën Tamarë -Vermosh loti 2 me kod WL-REC 46-2 me kontraktor C. S. EBG, pasi punimet e kryera sipas faturës nr. 27, datë 29.05.2017 në shumën me tvsh 3,582,960 lekë, referuar situacionin final në shumën totale të situacionit 563,953,381.97 lekë. Aktualisht në këtë situacion, punime të parashikuara që në preventiv dhe të paraqitura në faturën nr.27, datë 29.05.2017 janë shuma prej 2,985,800 lekë në zërat: "Bio- Engeneering works", "Kerbs end Footpath", "Gjeneral Items" të cilat duhet të kishin përfunduar brenda afatit të kontraktuar 23.11.2016. Theksohet se në letërkëmbimet me KfW për punimet shtesë, nga FSHZH është cituar në mënyrë të vazhdueshme, që nuk do të ketë shtyrje afati. Llogaritjet e kryera referuar sanksioneve të vendosura në kontratë (neni 8.7 dhe 14.5 b) me 0.05 % për çdo ditë vonesë, kanë rezultuar një sanksion të pa mbajtur në shumën 266,254.8 lekë (2,385,800 lekë x 0.05 % x 186 ditë vonesë x 20% TVSH) vetëm për zërat: "Bio- Engeneering works", "Kerbs end Footpath", të cilat ishin të parashikuara në preventivin fillestar si dhe mund të duheshin të realizoheshin brenda afatit të kontraktuar.

Kjo shumë konsiderohet dem ekonomik dhe detyrim i kontraktorit kundrejt FSHZH (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 32-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

-Rekomandimi:-Të kontabilizohet dhe kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës prej **266,254 lekë, përkatësisht nga kontraktori "C. S. E."** vlerë e cila përbën penalitet të pa mbajtur.

Menjëherë

B. 2 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Është konstatuar përdorim pa efektivitet dhe pa eficiencë i fondeve, me efekt negativ financiar me vlerë 11,850,694 lekë, detajuar si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se nga FSHZH nuk është respektuar skedula e disbursimeve e përcaktuar në ligjin nr. 10407, datë 31.03.2011, të ndryshuar me ligjin nr. 139/2014“Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe KfW Frankfurt Am Main për financimin e programit “Fondi i investimeve sociale IV”, (kjo si rezultat i ecurisë së nënprojekteve të investimeve në rrugë dhe ujësjellës jo sipas parashikimeve të grafikut kohor të punimeve). Kjo ka bërë që tarifa e përkushtimit e paguar nga Ministria e Financave si huamarrësi, të jetë e ndryshme nga ajo e planifikuar konform tabelës së disbursimeve të miratuar me ligjet sa më sipër. Për këtë nga Ministria e Financave është paguar **52,534.05 euro** (137,444.05 – 84,910) më shumë për këtë tarifë nga ajo e planifikuar sipas planit të disbursimeve të miratuar në ligjin nr. 139/2014 e cila konsiderohet efekt financiar negativ në zbatimin e projektit “Fondi i Investimeve Sociale IV” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 32-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.-Rekomandimi:- Nga titullari i FSHZH të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për efektin financiar të krijuar në shumën 52,534.05 euro (shuma e paguar 137,444.05 – shuma e planifikuar 84,910) si kosto shtesë e paguar nga Ministria e Financave për tarifën e përkushtimit (gjatë viteve 2013 - 30 Qershor 2018), referuar skedulës së miratuar të disbursimeve me ligjin e ratifikimit të marrëveshjes së kredisë, si dhe të merren vendimet përkatëse, në mënyrë që të parandalohen raste të tilla në të ardhmen.

Brenda datës 31.12.2018

2. Gjetje nga auditimi: Bazuar në marrëveshjen e investimit të lidhur më datë 16.06.2014 ndërmjet FSHZH dhe ish-Komunës Gjegjan për financimin e objektit dhe kontratës së punimeve të lidhur më datë 30.06.2014 ndërmjet FSHZH dhe kontraktorit të punimeve JV H. a. I për ndërtimin e objektit të sipërpërmendur si dhe marrëveshjes së funksionim mirëmbajtjes me datë 27.02.2015 ndërmjet FSHZH dhe komunës Gjegjan si dhe pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të punimeve me datë 10.06.2015 nga supervizori i punimeve, palët kanë rënë dakord dhe kanë marrë në dorëzim objektin ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Gojan i Madh duke nënshkruar certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve në Gjegjan në datë 23.06.2015. Certifikata është nënshkruar nga ish kryetari i komunës Gjegjan, nga kontraktori, supervizori dhe përfaqësuesit e FSHZH.

Për investimin e kryer për ndërtimin e ujësjellësit të fshatit Gojan i Madh në bazë të kontratës është parashikuar që numri i përfituesve të jetë 878.

-Sipas zërit J.3.8.1.2.17 janë vendosur 209 sahatë matës, të cilët përfaqësojnë edhe numrin e abonentëve të lidhur me rrjetin e ujit të pijshëm. Punimet i janë dorëzuar pushtetit vendor (Ish-Komunës Gjegjan, Pukë) po me këtë numër sahatësh. Nga verifikimi i punimeve të zbatuara për këtë zonë rezulton se janë hequr nga pusetat 24 sahatë matës të cilët janë në ruajtje nga SHA “Ujësjellës Kanalizime” Pukë. Heqja e 24 sahatëve matës është bërë për arsye ruajtje nga dëmtimet, pasi abonentë nuk kanë kërkuar të vazhdojnë më tej furnizimin me ujë të pijshëm. Sa më sipër, rezulton se nga ana e Ish-komunës Gjegjan Pukë, dhe tani nga ana e SHA “Ujësjellës Kanalizime” Pukë (pasi e ka marrë në dorëzim këtë ujësjellës), nuk janë marrë masat e duhura për menaxhimin e ujësjellësit të Fshatit Gojan i Madh, në kundërshtim me Marrëveshjen

Përfundimtare të Investimit datë 16.06.2014, pika 1.11 “Detyrimet e qeverisjes vendore”, ku përcaktohet që *ky investim do të administrohet drejtpërdrejtë ose nën përgjegjësinë e Komunës/bashkisë dhe do të funksionojë dhe mirëmbahet, në mënyrë të tillë që të shërbejë për qëllimin për të cilin ai është financuar*”.

Duke marrë në konsideratë vlerën e shpenzuar për këtë ujësjellës në shumën 28,576,564, e cila ishte parashikuar për 209 abonentë dhe shërbimin e furnizimit me ujë që në momentin e auditimit kryhet për 181 abonentë ose për 86 % të tyre, **vlera 4,000,718 lekë** (28,576,564 x 14 %), konsiderohet si shpenzim pa efektivitet (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 60-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 -Rekomandimi: - FSHZH, për projektet në vazhdimësi të monitorojë më korrektësi procesin e përzgjedhjes së objekteve për investim, si dhe të ndjekë në mënyrë korrekte zbatimin e marrëveshjes së investimit me njësitë e qeverisjes vendore, në mënyrë që fondet e implementuara të shfrytëzohen më me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet.

Në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Preventivi i tenderimit për Kontratën e punimeve civile me objekt “Ndërtimi i 15 skemave të ujësjellësve në zonat Shkodër, Kukës dhe Dibër”, është hartuar duke parashikuar shpenzime në 15 skemat e ujësjellësve të parashikuara për ndërtim, ndërkohë që specifikimet teknike parashikojnë që zyrat për mbikëqyrësin e punimeve duhet të instaloheshin në 4 zona, konkretisht në Arras, Kukës, Shkodër dhe Bruc, zyra të cilat do të shërbenin edhe për zonat e tjera të kontratës. Preventivi duhet të përfshinte zëra shpenzimesh vetëm për këtë zonë, siç përcaktohet në specifikimet teknike dhe jo për të 15 fshatrat. Bazuar në këtë preventiv, kontraktori ka parashikuar shpenzime në 15 skemat me çmim 100,000 lekë secili, me shumë totale 1,800,000 lekë, ndërkohë që për katër zonat e parashikuara të instalohen zyra ky shpenzim është 480,000 lekë. Si pasojë e këtij veprimi, është shkaktuar efekt negativ financiar me vlerë 1,320,000 lekë, për arsye se ky veprim është bërë para fazës së tenderimit dhe operatorët ekonomikë kanë plotësuar ofertën për 15 skema (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 49-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 -Rekomandimi:- FSHZH, duhet të monitorojë siç duhet zbatimin e një projekti që në fazën e hartimit të termave të referencës, specifikimeve teknike, vizatimeve dhe preventivave, me synim përfitimin e kostos sa më ekonomike në interes të buxhetit të shtetit, në zbatimin e kontratave të punimeve civile, mallra apo shërbime.

Në vazhdimësi

C. Për faktin se audituesit e grupit kanë qenë edhe me ngarkesa të tjera dhe të pakët në numër, ky auditim nuk i ka arritur pritshmëritë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R